



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-085

PËR BUJQËSI ORGANIKE

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

LIGJ PËR BUJQËSI ORGANIKE

KREU I
DISPOZITAT E PERGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të krijojë bazën për zhvillimin e qëndrueshëm të prodhimit organik si dhe të sigurojë funksionimin efikas të tregut duke garantuar konkurrencë të drejtë, besimin e konsumatorëve dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve.

2. Ky ligj përcakton objektivat dhe parimet përsa iu përket:

2.1. të gjitha fazave të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së produkteve organike dhe kontrollit të tyre;

2.2. përdorimit të indikatorëve që ju referohen etiketimit dhe reklamës së prodhimeve organike.

Neni 2 **Fusha e zbatimit**

1. Ky ligj do të zbatohet për produktet në vijim me origjinë nga prodhimi organik, përfshirë akuakulturën, atje ku këto produkte janë vendosur në treg, apo synohet të vendosen në treg:

1.1. produkte bujqësore dhe blegtorale të gjalla ose të papërpunuara;

1.2. produkte bujqësore të përpunuara për përdorim ushqimor;

1.3. ushqim për kafshë;

1.4. material riprodhues bimor dhe farëra për kultivim;

1.5. tharma të përdorura si ushqim dhe ushqim për kafshë: Produktet nga gjuetia e kafshëve të egra dhe peshkimi nuk do të konsiderohen prodhim organik.

2. Për cilindo operator të përfshirë në aktivitete në çfarëdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së produkteve me origjinë nga prodhimi organik, përfshirë operatorët e shërbimit të restauranteve në shkallë të gjërë, për të cilët duhet të vendosen rregulla specifike.

Neni 3 **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Prodhim organik** - përdorimi i metodave të prodhimit në përputhje me rregullat e caktuara më këtë ligj, në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes;

1.2. **Faza të prodhimit përgatitjes dhe shpërndarjes** - cilado fazë nisur nga prodhimi fillestar i një prodhimi organik deri në ruajtjen, përpunimin, transportin, shitjen apo furnizimin e konsumatorit të fundit, dhe aty ku lidhet me të, etiketimin, reklamën, importin, eksportin dhe nënkontraktimin;

1.3. **Organik** - përfituar nëpërmjet prodhimit organik apo të lidhur me të;

1.4. **Operator** - person fizik apo juridik përgjegjës për përmbushjen e kërkesave të këtij Ligji në kuadrin e veprimtarisë organike nën kontrollin e tij;

1.5. **Prodhim bimor** - prodhimi i produkteve bujqësore bimore dhe mbledhja e frutave të malit me qëllim tregtimi;

1.6. **Prodhim blegtoral** - prodhimi i kafshëve, shpendëve shtëpiake dhe insketet;

1.7. **Akuakulturë** - mbarështimi apo kultivimi i organizmave ujorë duke përdorur teknika të hartuara për të rritur prodhimtarinë e organizmave përtej kapacitetit natyror të mjedisit, organizmat mbesin pronë e një personi fizik dhe juridik gjatë gjithë fazës së mbarështimit apo kultivimit përfshirë mbledhjen apo vjeljen e tyre;

1.8. **Konvertim** - periudha kalimtare nga bujqësia jo organike në bujqësi organike brenda një periudhe kohore, gjatë së cilës ka përfunduar zbatimin i rregullave të prodhimit organik;

1.9. **Përgatitje** - veprimet për ruajtjen dhe përpunimin e produkteve organike, përfshirë thyerjen dhe kategorizimin në pjesë të produkteve blegtorale, paketimin, etiketimin dhe ndryshimet e bëra në etiketimin për sa i përket metodës së prodhimit organik;

1.10. **Ushqim apo artikuj ushqimorë** - çfarëdo substancë apo produkt i përpunuar, pjesërisht i përpunuar apo i papërpunuar, i cili synohet apo pritet të konsumohet nga njerëzit si, pije dhe çfarëdo substancë tjetër, përfshirë ujin, e cila është përzier me dashje në ushqim gjatë përpunimit, përgatitjes apo trajtimit të tij.

1.11. **Ushqim për kafshë** - çdo substancë apo produkt, përfshirë aditivët, i përpunuar, pjesërisht i përpunuar apo i papërpunuar, i cili synohet të përdoret për t'ua dhënë kafshëve si ushqim.

1.12. **Vendosje në treg** - vendosje me qëllim shitje e ushqimit apo ushqimit të kafshëve, përfshirë ato që synohen për shitje apo ndonjë formë tjetër e dhënies së tyre, shpërndarja dhe forma të tjera të dhënies së tyre.

1.13. **Etiketim** - çdo term, fjalë, shënim, detaj, markë prodhimi, vulë tregu, figurë apo shenjë që lidhet dhe vendoset mbi çdo paketim, dokument, njoftim, etiketë, fletëz kartoni, shirit apo qafore që shoqëron ose i referohet një produkti;

1.14. **Produkt ushqimor i parapaketuar** - çfarëdo artikull i veçantë për t'iu paraqitur si i tillë konsumatorit të fundit dhe shërbimit të restoranteve kolektive, i cili përbëhet nga një produkt ushqimor dhe paketimi në të cilin ka qenë futur para se të jepet për shitje, edhe në se ky paketim e mbulon tërësisht apo vetëm pjesërisht artikullin ushqimor, por në çdo rast në mënyrë të tillë që përmbajtja të mos mund të ndryshohet pa e hapur apo ndryshuar paketimin;

1.15. **Reklamë** - çfarëdo paraqitje e cila i bëhet publikut me mjete të ndryshme nga etiketa, i cili synon apo mund të ndikojë dhe përcaktojë qëndrime, bindje dhe sjellje për të nxitur drejtpërdrejt a tërthorazi shitjen e produkteve organike;

1.16. **Autoritet kompetent** - Ministria është kompetente për organizimin e kontrolleve në fushën e prodhimit organik në pajtim me dispozitat e përcaktuara në këtë ligj, kur është e nevojshme, përfshin edhe autoritetin homolog publik të një vendi të tretë.

1.17. **Autoriteti i Kontrollit** - është organizatë administrative publike të cilës autoriteti kompetent mund t'i japë, në tërësi apo pjesërisht, kompetencat e veta për inspektimin dhe çertifikimin në fushë të prodhimit organik në përputhje me dispozitat e përcaktuara me këtë ligj, kur shihet e përshtatshme, mund t'i jepet edhe një autoriteti homolog që operon në një vend të tretë;

1.18. **Trup i kontrollit** - një njësi e pavarur private, e cila kryen inspektimin dhe çertifikimin në fushën e prodhimit organik në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë Ligj; gjithashtu, kur shihet e përshtatshme, njësia homologe i një vendi të tretë apo njësia homologe e cila operon në një vend të tretë;

1.19. **Markë e konformitetit** - një markë që vërteton përputhshmërinë me një tërësi të caktuar të standardeve apo dokumenteve tjera normative;

1.20. **Përbërës** - çfarëdo substancë, përfshirë aditivet dhe enzimët, e përdorur në përpunimin apo përgatitjen e një artikulli ushqimor të pranishme në produktin përfundimtar. Kur një përbërës i artikullit ushqimor është vetë produkt i disa përbërësve, ky i fundit do të konsiderohet përbërës i artikullit ushqimor.

1.21. **Produkte për mbrojtjen e bimëve** - lëndë aktive dhe preparate që përmbajnë një ose më shumë lëndë aktive, në formën që ato i jepen përdoruesit për: mbrojtjen e bimëve ose produkteve bimore nga gjithë organizmat e dëmshëm apo parandalimin e veprimit të këtyre organizmave, ndikimin në proceset jetësore të bimëve, jo si lëndë ushqyese, ruajtjen e produkteve bimore, shkatërrimin e bimëve të padëshiruara, pjesëve të bimëve, apo luftimin dhe parandalimin e rritjes së padëshiruara të bimëve;

1.22. **Organizma të modifikuara gjenetike (OMGJ)** - një organizëm, me përjashtim të qenieve njerëzore, në të cilin materiali gjenetik është ndryshuar në një mënyrë që nuk ndodh natyrshëm nga çiftëzimi dhe rikombinimi i natyrshëm.

1.23. **Prodhuar nga OMGJ-të** - me prejardhje tërësisht apo pjesërisht nga OMGJ-të, por që nuk përmban apo përbëhet nga OMGJ-të;

1.24. **Përftuar nga OMGJ-të** - të përfuara duke përdorur një OMGJ si organizmi më i fundit i gjallë në procesin e prodhimit, por që nuk përmban apo përbëhet nga OMGJ-të dhe as i prodhuar nga OMGJ-të;

1.25. **Aditivë në ushqimet për kafshë** - lëndë, mikroorganizma apo preparate, të ndryshme prej ushqimit të kafshëve dhe parapërzjerje, të cilat i shtohen qëllimisht ushqimit të kafshëve apo ujit në mënyrë që të përftohen, një apo më tepër funksione si në vijim:

1.25.1. ndikojnë në përmirësimin e veçorive të ushqimit të kafshëve;

1.25.2. ndikojnë në përmirësimin e veçorive të prodhimeve blegtorale,

1.25.3. ndikojnë në përmirësimin e ngjyrave të peshqve dhe zogjve dekorativë;

1.25.4. plotësojnë nevojat e të ushqyerit të kafshëve,

1.25.5. përmirësojnë pasojat mjedisore që sjell prodhimi i kafshëve,

1.25.6. ndikojnë në përmirësimin e prodhimtarisë shtazore, performacën apo mirëqenien, sidomos duke ndikuar florën gastrointestinale apo tretshmërinë e ushqimeve të kafshëve,

1.25.7. kanë efekt koksidiostatik dhe histomonostatik.

1.26. **Ekivalent** - në përshkrimin e sistemeve apo masave të ndryshme: ato që janë në gjendje të plotësojnë të njëjtat objektiva dhe parime duke zbatuar rregulla të cilat sigurojnë të njëjtin nivel sigurie për përputhje midis tyre ;

1.27. **Lëndë ndihmëse në përpunim** - çdo lëndë që nuk konsumohet veçmas si ushqim, që përdoret qëllimisht në përpunimin e lëndëve, ushqimeve apo përbërësve të tyre të papërpunuar, për të arritur një qëllim të caktuar teknologjik gjatë trajtimit apo përpunimit dhe e cila mund të sjellë prani të paqëllimshme, por teknikisht të pashmangshme, të mbetjeve të kësaj lënde apo derivateve të saj në produktin përfundimtar, me kusht që këto mbetje të mos përbëjnë rrezik për shëndetin dhe të mos kenë ndonjë efekt teknologjik në produktin përfundimtar.

1.28. **Rrezatim jonizues** - transferim i energjisë në formë grimcash elementare ose valësh elektromagnetike me gjatësi njëqind (100) nanometër apo më të vogël ose me frekuencë 3×10^{15} Hertz apo më të madhe në gjendje të prodhojë jone drejtpërdrejt ose jo drejtpërdrejt.

1.29. **Shërbime restaurantesh kolektive** - përgatitja e produkteve organike në restorante, spitale, mensa dhe njësi të ngjashme ushqimore në pika shitje apo shpërndarje për konsumatorin përfundimtar.

1.30. **Kontroll** - çdo formë kontrolli e cila kryhet nga autoriteti kompetent apo nga një autoritet kontrolli për verifikimin e përputhjes me legjislacionin lidhur me metodën e prodhimit organik, përfshirë inspektimin, auditimin, verifikimin, marrjen e mostrave, testimin, analizat dhe mbikëqyrjen;

1.31. **Jo-organik** - që nuk vjen nga apo që nuk ka të bëjë me prodhimin sipas këtij ligji;

1.32. **Produkte mjekësore veterinare** - produktet si në vijim:

1.32.1. çdo substancë apo kombinim substancash që jepen për trajtimin apo parandalimin e sëmundjeve për kafshë;

1.32.2. çdo substance apo kombinim i substancave, të cilat mund t'u jepen kafshëve për të bërë një diagnozë mjekësore, për të rimëkëmbur, korrigjuar apo ndryshuar funksionet fiziologjike në kafshë, konsiderohen edhe si produkt mjekësor veterinar.

1.33. **Importues** - personi fizik apo juridik, i cili sjell produktet organike - ngarkesë, mall, për ta vendosur në qarkullim të lire në Kosovë, si personalisht ashtu edhe nëpërmjet një përfaqësuesi.

1.34. **Marrës i parë në dorëzim** - personi fizik apo juridik të cilit i dorëzohet ngarkesa e prodhimit organik të importuar dhe i cili do ta pranojë atë për përgatitjen dhe tregtimin e mëtejshëm;

1.35. **Fermë** - të gjitha njësitet e prodhimit që veprojnë nën një menaxhimi të vetëm me qëllim prodhimin e produkteve bujqësore;

1.36. **Njësi prodhimi** - të gjitha asetet dhe mjetet që përdoren në një sektor prodhimi kushte paraprake prodhimi, ngastrat e tokës, kullotat, sipërfaqet e hapura, ndërtimet blegtorale, hurdat e peshqeve, sistemet mbajtëse për shtazë në akuakulturë, koncesione të dhëna në brigje lumejsh apo liqenesh, vende për ruajtjen e prodhimeve bujqësore, blegtorale, lëndë e parë e papërpunuar dhe çdo faktor prodhimi tjetër i rëndësishëm për këtë sektor të veçantë prodhimi;

1.37. **Tajtim veterinar** - të gjitha trajtimet kuruese për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme të kafshëve.

1.38. **Ushqime për kafshë në konvertim** - ushqime për kafshët të prodhuara gjatë periudhës së konvertimit drejt prodhimit organik, me përjashtim të atyre që janë mbledhur, korrur, kositur a vjelë dymbëdhjetë (12) muaj pas fillimit të konvertimit.

1.39. **Shfrytëzim i qëndrueshëm në akuakulturë** - është shfrytëzimi i një stoku në mënyrë të tillë që mos të dëmtohet shfrytëzimi i ardhshëm i tij dhe të mos ketë ndikim negativ në ekosistemin ujor.

1.40. **Faktor prodhimi** - janë gjithë inputet, si plehra, përmirësues, produkte për mbrojtjen e bimëve, farëra, bimë, aditivë, të cilat përdoren në fazat e prodhimit dhe përpunimit të produkteve organike.

1.41. **Ministria** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

KREU II

OBJEKTIVAT DHE PARIMET E PRODHIMIT ORGANIK

Neni 4

Objektivat e përgjithshme

1. Prodhimi organik ka këto objektiva të përgjithshme për vendosjen e një sistemi të qëndrueshëm të drejtimit të bujqësisë, i cili:

- 1.1. respekton sistemet dhe ciklet e natyrës dhe ruan e përmirëson gjendjen shëndetësore të tokës, ujit, bimëve, kafshëve dhe ekuilibrin ndërmjet tyre;
- 1.2. kontribuon në shkallë të lartë për diversitetin biologjik;
- 1.3. siguron përdorim të përgjegjshëm të energjise dhe resursve natyrore si uji, toka, lënda organike dhe ajri;
- 1.4. respekton standarde të larta për mirëqenie të kafshëve dhe në veçanti përmbush kërkesat specifike jetësore të kafshëve sipas llojeve;
- 1.5. prodhimin e produkteve me cilësi të lartë;
- 1.6. prodhimin e një shumëllojshmërie ushqimesh dhe produkte të tjera bujqësore, të cilat iu përgjigjen kërkesave të konsumatorëve për artikujt e prodhuar duke zbatuar procese të cilat nuk dëmtojnë mjedisin, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve apo kafshëve.

Neni 5

Parimet e përgjithshme

1. Prodhimi organik duhet të bazohet në parimet e përgjithshme, planifikim dhe drejtim të duhur të proceseve biologjike në bazë të sistemeve ekologjike të cilat përdorin burime natyrore brenda të njëjtave sisteme me metoda të cilat:

- 1.1. përdorin organizma të gjalla dhe metoda mekanike të prodhimit;
- 1.2. praktikojnë kultivimin e bimëve dhe, mbarështrimin e kafshëve blegtorale që lidhen me tokën apo zhvillojnë aktivitet të akuakulturës në përputhje me parimet e shfrytëzimit të qëndrueshëm të peshkimit;
- 1.3. përjashtojnë përdorimin e OMGJ-ve dhe të produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ me përjashtim të produkteve mjekësore veterinare;
- 1.4. bazohen në vlerësim të rrezikshmërisë dhe në marrjen e masave paraprake dhe parandaluese kur është e nevojshme.

2. Kufizim të përdorimit të faktorëve të prodhimit të jashtëm. Kur faktorët e prodhimit të jashtëm janë të nevojshëm apo kur nuk ekzistojnë praktikatat dhe metodat e duhura të drejtimit sipas paragrafit 1, të këtij neni, atëherë ato do të kufizohen në:

- 2.1. faktorë prodhimi nga prodhimi organik;
- 2.2. substanca natyrore apo që vijnë nga substanca natyrore,
- 2.3. plehra minerale me tretshmëri të ulët.

3. Kufizim i rreptë i përdorimit të faktorëve të prodhimit të përftuar nga sinteza kimike, përveç rasteve të jashtëzakonshme kur:

- 3.1. nuk ekzistojnë praktikat e duhura drejtimi;
- 3.2. nuk gjenden në treg faktorët e prodhimit të jashtëm që i referohen paragrafit 2 të këtij neni; apo
- 3.3. përdorimi i faktorëve të jashtëm që i referohen paragrafit 2 të këtij neni kontribuon në krijimin e një ndikimi mjedisor të papranueshëm;
- 3.4. përshtatje, kur është e nevojshme, sipas këtij ligji, e rregullave të prodhimit organik, duke marrë parasysh gjendjen shëndetësore, dallimet rajonale të klimës dhe të kushteve lokale, fazat e zhvillimit dhe praktikatat e veçanta blegtorale.

Neni 6

Parimet specifike të zbatueshme në bujqësi

1. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 5. të këtij ligji, bujqësia organike do të bazohet në parimet specifike si në vijim:

- 1.1. mirëmbajtje dhe përmirësim i jetës dhe pjellorisë natyrore të tokës, qëndrueshmëri e tokës dhe biodiversiteti i saj duke parandaluar dhe luftuar ngjeshjen dhe erozionin e tokës dhe të ushqyerit e bimëve kryesisht nëpërmjet ekosistemit të tokës;
- 1.2. minimizim i përdorimit të burimeve jo-ripërtëritëse dhe faktorëve të prodhimit jashtë fermës;
- 1.3. riciklim i mbeturinave dhe nënprodukteve me orgjinë bimore dhe shtazore si faktorë prodhimi në prodhimtarinë bimore dhe shtazore;
- 1.4. marrje parasysh e ekuilibrit ekologjik lokal dhe rajonal kur merren vendime për prodhimin;

1.5. mbrojtje e shëndetit të kafshëve duke stimuluar mbrojtjen imunologjike natyrore të kafsheve, si dhe perzgjedhjen e racave të përshtatëshme dhe të praktikave zooteknike;

1.6. mbrojtje e bimëve nëpërmjet masave parandaluese, si zgjedhja e llojeve të përshtatshme dhe e varieteteve të qëndrueshme ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve, qarkullimet e duhura të kulturave bujqësore, metodat mekanike dhe fizike dhe mbrojtja e armiqve natyrorë të dëmtuesve;

1.7. zbatim i praktikave të prodhimit blegtoral që i përshtaten vendit dhe të lidhura me tokën.

1.8. ruajtje e një shkalle të lartë të mirëqenies të kafshëve duke respektuar kërkesat specifike të llojeve;

1.9. prodhim i produkteve blegtorale organike nga kafshë të cilat janë rritur në ferma organike që nga lindja apo çelja dhe gjatë gjithë jetës së tyre;

1.10. zgjedhje e racave duke marrë parasysh aftësinë e kafshëve për t'iu përshtatur kushteve, vitalitetin dhe qëndrueshmërinë e tyre ndaj sëmundjeve apo problemeve shëndetësore;

1.11. ushqim i kafshëve me ushqim kafshësh organik, i cili përbëhet nga përbërës që vijnë nga bujqësia organike dhe nga substanca natyrore me origjinë jo bujqësore;

1.12. zbatim i praktikave zooteknike të mbarështimit, të cilat forcojnë sistemin imunitar dhe rrisin mbrojtjen natyrore kundër sëmundjeve, sidomos duke përfshirë kondicionime fizike të rregullta kur është e nevojshme, qasje në mjedise të hapura dhe në kullota;

1.13. përjashtim i mbarështimit të kafshëve poliploide të krijuara në rrugë artificiale;

1.14. mirëmbajtje e biodiversitetit të ekosistemeve natyrore ujore, vazhdimësi kohore e shëndetit të mjedisit ujor dhe cilësisë së ekosistemeve ujore dhe tokësore përreth;

1.15. ushqim i organizmave ujorë me ushqim kafshësh që vjen nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit, ose me ushqim kafshësh organik të përbërë nga përbërës bujqësorë nga bujqësia organike dhe nga substanca natyrore jo bujqësore.

Neni 7

Parimet specifike për zbatim në përpunimin e ushqimit organik

1. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, prodhimi i ushqimeve organike të përpunuara bazohet në parimet specifike si në vijim:

1.1. prodhim i ushqimeve organike me përbërës që vijnë nga bujqësia organike, përveç se, kur një përbërës nuk gjendet në treg në formë organike;

1.2. kufizim i përdorimit të shtesave të ushqimit, të përbërësve jo organikë me funksione kryesisht sensoriale e teknologjike si dhe të mikropërbërësve ushqimorë dhe i lëndëve ndihmëse në përpunim, në mënyrë që ato të përdoren në shkallë minimale dhe vetëm në raste nevojë të domosdoshme teknologjike ose për qëllime të veçanta ushqimore;

1.3. përjashtim i përdorimit të substancave dhe i metodave të përpunimit, të cilat mund të keqësojnë natyrën e produktit;

1.4. përpunim me kujdes i ushqimit, duke u dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

Neni 8

Parimet e specifike për zbatim në përpunimin e ushqimit organik për kafshë

1. Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji, prodhimi i ushqimit organik të përpunuar për kafshët do të bazohet në parimet specifike në vijim:

1.1. prodhim i ushqimit organik për kafshë nga lëndë ushqyese organike, përpos kur një lëndë e tillë nuk gjendet në treg në formë organike;

1.2. kufizim i përdorimit të lëndëve aditive ushqyese për kafshë dhe i lëndëve ndihmëse në përpunim në një shkallë minimale dhe vetëm në rastin e një nevojë esenciale teknologjike apo zooteknike apo për qëllime të të ushqyerit;

1.3. përjashtim i substancave dhe i metodave të përpunimit të cilat mund të keqësojnë natyrën e vërtetë të produktit;

1.4. përpunim me kujdes i ushqimit, duke u dhënë përparësi përdorimit të metodave biologjike, mekanike dhe fizike.

KREU III

RREGULLAT E SPECIFIKE TË PRODHIMIT

Neni 9

Ndalimi i përdorimit të OMGJ-ve

1. Në prodhimin organik ndalohej përdorimi i OMGJ-ve dhe i produkteve të prodhuara nga ose me OMGJ si ushqim, ushqim për kafshë, lëndë ndihmëse në përpunim, produkte për mbrojtjen e bimëve, plehra, përmirësues të tokës, farëra, material riprodhues vegjetativ, mikroorganizma dhe kafshë.

2. Për ndalimet sipas paragrafit 1. të këtij neni, operatorët do t'i kërkojnë palës shitëse të konfirmojnë që produktet për furnizim nuk kanë qenë të prodhuara nga ose me OMGJ.

Neni 10

Ndalimi i përdorimit të rrezatimeve jonizuese

Ndalohet përdorimi i rrezatimeve jonizuese për trajtimin e ushqimit organik apo ushqimit organik për kafshë, apo lëndëve të para që përdoren në ushqime organike apo ushqim organik për kafshë.

Neni 11

Rregullat e përgjithshme të prodhimit në fermë

1. Ferma bujqësore duhet të drejtohet në përputhje me kërkesat që zbatohen për prodhimin organik.

2. Vartësisht kushteve specifike të cilat duhet të përcaktohen me akt nënligjor, një fermë mund të ndahet në njësi të ndara qartë apo në njësi kultivimi në akuakulturë, ku jo në gjitha njësitë zbatohet prodhimi organik. Për kafshë, kjo zbatohet për lloje të ndryshme. Për akuakulture, kjo zbatohet për të njëjtin lloj, me kusht që të bëhet ndarje e përshtatshme e vendeve të prodhimit. Për bimë, kjo zbatohet për varietete të ndryshme lehtësisht të dallueshme.

3. Nëse, në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, kur prodhimtaria organike nuk kryhet në të gjitha njësitë e fermës, operatori e mban tokën, kafshët, dhe produktet e përdorura për, apo të prodhuara nga njësitë organike, të ndara nga ato që përdoren për, apo të prodhuara nga, njësitë jo organike dhe mban shënimet e duhura për të vërtetuar ndarjen.

Neni 12

Rregullat e prodhimit të bimëve

1. Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit bujqësor, në prodhimin organik bimor zbatohen rregullat si në vijim:

1.1. në prodhimin organik bimor përdoren praktika lavrimi dhe kultivimi që mbajnë apo rrisin lëndën organike në tokë, shtojnë qëndrueshmërinë dhe biodiversitetin e tokës, si dhe parandalojnë ngjeshjen e tokës dhe erozionin e tokës;

1.2. pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës mbahen përmes qarkullimeve shumëvjeçare të kulturave bujqësore, përfshirë bishtajoret dhe kulturat e tjera për plehrim të gjelbër, dhe duke përdorur pleh organik kafshësh apo lëndë organike të përfutuara nga prodhim organik, që të dyja mundësisht të kompostuara;

1.3. lejohet përdorimi i preparateve biodinamike;

1.4. plehrat dhe përmirësuesit e tokës mund të përdoren vetëm nëse ato janë të autorizuar të përdoren në prodhimin organik sipas nenit 16 të këtij ligji.;

1.5. nuk përdoren plehra minerale azotike;

1.6. të gjitha teknikat që përdoren për prodhim bimor duhet të mënjanojnë apo kufizojnë në minimum ndotjen e mjedisit;

1.7. parandalimi i dëmeve që shkaktohen nga dëmtuesit, sëmundjet dhe barërat e këqija bazohet kryesisht në mbrojtjen e dëmtuesve natyrorë të tyre, zgjedhjen e llojeve dhe varieteteve, qarkullimin bimor, teknikat e kultivimit dhe proceset termike;

1.8. në rast rreziku të madh për bimët, mund të përdoren produkte të mbrojtjes së bimëve vetëm nëse ato janë të autorizuar për përdorim në prodhimin organik ;

1.9. për prodhimin e produkteve të ndryshme nga farërat dhe materiali riprodhues vegjetative, duhet të përdoren vetëm farëra dhe material riprodhues të prodhuara me metoda organike. Për këtë qëllim, bima amë nga e cila përftohen farërat dhe bima prind nga e cila përftohet materiali riprodhues vegjetativ, kultivohen në pajtim me rregullat e përcaktuara në këtë ligj për të paktën një brezni, ose, në rastin e bimëve shumëvjeçare, dy sezone vegjetative;

1.10. produktet për pastrime dhe dezinfektive në prodhimin bimor do të përdoren vetëm nëse ato janë autorizuar për përdorim në prodhimin organik sipas nenit 16 të këtij ligji.

2. Grumbullimi i bimëve spontane dhe pjesëve të tyre, të cilat rriten të lira në zona natyrore, pyje dhe në sipërfaqe bujqësore konsiderohet si metodë prodhimi organike, me kusht që:

2.1. këto sipërfaqe, për një periudhë të paktën tre (3) vjeçare përpara grumbullimit të mos kenë qenë trajtuar me produkte të ndryshme prej atyre të autorizara për t'u përdorur në prodhim organik sipas nenit 16 të këtij ligji;

2.2. grumbullimi të mos ndikojë në qëndrueshmërinë e mjedisit natyror apo në ruajtjen e llojeve në sipërfaqet e grumbullimit.

3. Masat e nevojshme për zbatimin e rregullave të prodhimit që përmban ky nen do përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria .

Neni 13

Rregullat e prodhimit blegtoral

1. Lidhur me origjinën e kafshëve përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit bujqësor të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, në prodhimin organik blegtoral do të ndiqen rregullat në vijim:

1.1. kafshët organike lindin dhe rriten në ferma organike;

1.2. për qëllime riprodhimi në një fermë organike mund të vendosen kafshë të mbarështuara me metoda jo organike, me kushte të caktuara. Këto kafshë dhe produktet e tyre mund të konsiderohen organike pasi të kenë plotësuar periudhën e konvertimit sipas nenit 16 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 i këtij ligji;

1.3. kafshët e pranishme në fermë prej fillimit të periudhës së konvertimit dhe produktet e tyre mund të konsiderohen organike pasi të kenë plotësuar periudhën e konvertimit sipas nenit 16 paragrafi 1. nënparagrafi 1.3. i këtij ligji.

2. lidhur me praktikat blegtorale dhe kushtet e strehimit:

2.1. personeli që kujdeset për kafshët duhet të ketë njohuritë dhe aftësitë themelore të nevojshme lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve;

2.2. praktikat zooteknike, përfshirë dendësinë e tufës në një sipërfaqe, kushtet e strehimit të sigurojnë plotësimin e nevojave zhvillimore, fiziologjike dhe etologjike të kafshëve;

2.3. bagëtia të ketë qasje të përherëshme në sipërfaqet e hapura, me përparësi në kullota, gjithmonë kur e lejojnë kushtet atmosferike dhe gjendja e tokës, përveç rasteve kur, në bazë të legjislacionit vendor, janë vendosur kufizime dhe detyrime lidhur me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të kafshëve;

2.4. numri i bagëtisë të kufizohet me qëllim që të të minimizohet mbikullo-tja, tejngjeshja e tokës nga shkelja, ero-zioni, ose ndotja e shkaktuar nga kafshët apo nga shpërndarja e plehut të tyre;

2.5. kafshët nga fermat organike mbahen të ndara nga kafshët e tjera. Në kushte të caktuara kufizuese, lejohet kullotja e kafshëve nga fermat organike në sipërfaqe kullotash të perbashkta dhe e kafshëve jo organike në terrene organike;

2.6. ndalohet lidhja apo izolimi i kafshëve, përveç për një periudhë kohore të kufizuar dhe vetëm deri në caqet e justifikuara për arsye sigurimi, mirëqenie apo intervenime veterinare;

2.7. periudha e transportit të bagëtive duhet të jetë sa më e shkurtër;

2.8. gjatë jetës së kafsheve përfshirë edhe momentin e therrjes duhet të mbahen në minimum çdo vuajtje e kafshëve përfshirë edhe gjymtimet;

2.9. bletishtet vendosen në zona të cilat sigurojnë burime të mjaftueshme nektari dhe poleni, të cilat vijnë kryesisht nga kultivime organike dhe, sipas rastit, nga bimësia spontane ose nga pyje të menaxhuara jo me metoda organike, apo nga bimë të cilat janë trajtuar vetëm me metoda të cilat kanë ndikim të vogël mjedisor. Bletishtet duhet vendosen në një distance të mjaftueshme nga burimet që mund të shkaktojnë kontaminim të produkteve të bletarisë apo dëmtojnë shëndetin e bletëve;

2.10. zgjojet dhe materialet që përdoren në bletari do të bëhen kryesisht me materiale natyrore;

2.11. ndalohet vrasja e bletëve në hoje si metodë që shoqëron vjeljen e produkteve të bletarisë.

3. Sa i përket riprodhimit:

3.1. riprodhimi duhet të bëhet me metodat natyrore. Por lejohet inseminimi artificial;

3.2. riprodhimi nuk duhet të nxitet me trajtime hormonale apo me substanca të ngjashme, përveç në formë trajtimi terapeutik veterinar për një kafshë individuale;

3.3. nuk lejohen forma të tjera të riprodhimit artificial si klonimi dhe transferimi i embrioneve;

3.4. duhet të zgjidhen racat e përshtatshme. Zgjedhja e racave kontribuon edhe për të parandaluar ndonjë vuajtje dhe për të shmangur nevojën për gjymtimin e kafshëve.

4. Sa i përket ushqimit të kafshëve:

4.1. ushqimet për kafshë merren kryesisht nga ferma ku ato mbarështohen ose nga ferma të tjera organike në të njëjtin rajon;

4.2. bagetia ushqehet me ushqim organik i cili plotëson kërkesat ushqimore të kafshëve në faza të ndryshme të zhvillimit të tyre. Një pjesë e racionit mund të përmbajë ushqim për kafshë nga ferma të cilat janë në konvertim e sipër drejt bujqësisë organike;

4.3. me përjashtim të bletëve, bagetia do të ketë qasje të përhershme në kullota apo ushqime voluminoze sa më natyrore.

4.4. lëndët e para për ushqim kafshësh me origjinë bimore jo organike, lëndët e para me origjinë shtazore dhe minerale për ushqim kafshësh, lëndët shtesë për ushqim kafshësh, disa produkte të caktuara që përdoren në të ushqyerit e kafshëve dhe si lëndë ndihmëse në përpunim, përdoren vetëm nëse janë të autorizuar për t'u përdorur në prodhimin organik sipas nenit 15 të këtij ligji;

- 4.5. nuk duhet të lejohet përdorimi i stimuluesve të rritjes dhe i aminoacideve sintetike,
- 4.6. gjitarët në gji ushqehen me qumësht natyror, ku preferohet qumështi i nënës;
5. Lidhur me parandalimin e sëmundjeve dhe trajtimin veterinar:
- 5.1. parandalimi i sëmundjeve bazohet në zgjedhjen e racës dhe të krerëve, në zbatimin e praktikave zooteknike, në dhënie ushqimi me cilësi të lartë, ushtrime, dendësi e duhur e bagëtive dhe mbajtje e kushteve higjienike të shtallës;
- 5.2. sëmundjet trajtohen menjëherë për të shmangur vuajtjet e kafshëve, produktet mjekësore veterinarë alopatiche nga sinteza kimike, përfshirë antibiotikët, mund të përdoren kur është e nevojshme dhe në kushte të rrepta mbikqyrje, kur përdorimi i produkteve fitoterapeutike, homeopatike dhe i produkteve të tjera është i papërshtatshëm, përcaktohen në mënyrë të veçantë kufizimet lidhur me ciklet e trajtimit dhe me periudhat kur trajtimet duhet të ndërpriten;
- 5.3. lejohet përdorimi i medikamenteve veterinarë imunologjike;
- 5.4. lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të kafshëve të vendosura në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 5.5. lidhur me pastrimin dhe dezinfekimin, produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e stallave dhe impiantev blegtorale, duhet të përdoren vetëm nëse janë të autorizuar për përdorim në prodhimin organik sipas nenit 16 të këtij ligji.
6. Masat e nevojshme për zbatimin e rregullave të prodhimit përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 14 **Rregullat e prodhimit në akuakulturë**

1. Përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit në fermë të përcaktuara në nenin 11 të këtij ligji, për prodhimin origjinën dhe llojet në akuakulturë zbatohen rregullat si në vijm:
- 1.1. akuakultura organike bazohet në rritjen e brezit të ri me orgjinë nga prindër organikë dhe nga ferma organike.
- 1.2. kur nuk gjendet brez i ri nga prindër ose ferma organike, në kushte të veçanta në fermë mund të sillen edhe brezi i ri i prodhuar në mënyrë jo organike.
2. sa i përket praktikave zooteknike:

- 2.1. personeli që merret me akuakulturë duhet të ketë njohuritë themelore të nevojshme lidhur me shëndetin dhe nevojat e mirëqenies të peshqve dhe krustaceve në akuakulturë.
- 2.2. praktikat zooteknike, përfshirë të ushqyerit, projektimin e impianteve, dendësia e peshqve dhe krustaceve në akuakulturë dhe cilësia e ujit duhet të sigurojnë plotësimin e nevojave zhvillimore, fiziologjike dhe të qëndrimit të tyre;
- 2.3. praktikat zooteknike të kufizojnë në minimum ndikimet negative mjedisore që vijnë nga fermat duke përfshirë ikjet e stoqeve nga ferma;
- 2.4. peshqit dhe krustacet organike duhet të mbahen të ndara nga peshqit dhe krustacet e tjera që rriten në akuakulturë.
- 2.5. gjatë transportit të sigurohet ruajtja e mirëqenies .
- 2.6. bëhet çmos që gjatë jetës së tyre e madje edhe në çastin e therjes, peshqit dhe krustacët të vuajnë sa më pak;

3. Sa i përket riprodhimit:

- 3.1. nuk duhet të përdoret nxitje artificiale e poliploidisë, hibridizim artificial, klonim dhe krijim racave një gjinore, përveç ndarjes me dorë;
- 3.2. duhet të zgjidhen individët e përshtatshëm;
- 3.3. krijohen kushte specifike sipas llojeve për mbarështimin e riprodhuesve, të riprodhimit dhe prodhimit të farës.

4. Sa i përket ushqimit për peshq dhe krustacë:

- 4.1. duhet të ushqehen me ushqime të cilat plotësojnë nevojat ushqimore të kafshëve në fazat e ndryshme të zhvillimit të tyre;
- 4.2. pjesa bimore e ushqimit duhet të ketë origjinë nga prodhimi organik dhe pjesa e ushqimit e përfituar nga peshq, krustacë e gjallesa ujore duhet të jetë me origjinë nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i peshkimit;
- 4.3. lëndët ushqimore bimore jo organike, lëndët ushqimore shtazore dhe minerale, shtesat e ushqimit, disa produkte që përdoren në ushqimin e kafshëve dhe si lëndë ndihmëse në përpunim, përdoren vetëm nëse janë autorizuar për përdorim në prodhimin organik sipas nenit 15 të këtij ligji;
- 4.4. nuk lejohet përdorimi i stimuluesve të rritjes dhe i aminoacideve sintetike.

5. Sa i përket parandalimit të sëmundjeve dhe trajtimit veterinar:

5.1. parandalimi i sëmundjeve duhet të bazohet në mbajtjen e peshqve dhe krustaceve në akuakulturë në kushte optimale duke i vendosur në vende të përshtatshme dhe projektimit optimal të fermës, në zbatimin e praktikave të mira të mbarështimit dhe drejtimit, përfshirë pastrimin dhe dezinfektimin periodik të impianteve, në ushqimin me cilësi të lartë, dendësinë e përshtatshme të këtyre gjallesave, zgjedhjen e racës dhe të individëve;

5.2. sëmundjet duhet të trajtohen menjëherë për të shmangur vuajtjet e kafshëve, produktet mjekësore veterinarë alopatiche nga sinteza kimike, përfshirë antibiotikët, mund të përdoren kur është e nevojshme dhe në kushte të rrepta mbikqyrje, kur përdorimi i produkteve fitoterapeutike, homeopatike dhe i produkteve të tjera është i pa përshtatshëm. Përcaktohen në mënyrë të veçantë kufizimet lidhur me ciklet e trajtimit dhe me periudhat kur trajtimet duhet të ndërpriten;

5.3. lejohet përdorimi i medikamenteve veterinarë imunologjike;

5.4. lejohen trajtimet që lidhen me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe të kafshëve të vendosura në bazë të Legjislacionit në fuqi;

5.5. sa i përket pastrimit dhe dezinfektimit, produktet për pastrimin dhe dezinfektimin e hurdhave, kafazeve, ndërtesave dhe impianteve, do të përdoren vetëm nëse janë të autorizuara për përdorim në prodhimin organik sipas nenit 15 të këtij ligji.

6. Masat dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e rregullave të prodhimit në akuakulturë, përcaktohen me akt nënligjorë të nxjerrë Ministria.

Neni 15

Produktet dhe substancat që përdoren në bujqësi dhe kriteret për autorizimin e tyre

1. Autoriteti Kompetent, përmes akteve nënligjore, autorizon për përdorim në prodhimin organik produkte dhe substanca që mund të përdoren në bujqësinë organike dhe i paraqet ato në lista të kufizuara për qëllimet si në vijim:

1.1. produkte për mbrojtjen e bimëve;

1.2. plehra dhe si përmirësues të dheut;

1.3. lëndë të para bimore për ushqime jo organike për kafshë, lëndë të para me origjinë shtazore dhe minerale për ushqim për kafshë dhe substanca të caktuara që përdoren në ushqimin e kafshëve;

1.4. shtesa ushqimore dhe lëndë ndihmëse në përpunim;

1.5. produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e hurdhave, kafazeve, ndërtesave dhe impianteve që përdoren në prodhimin blegtoral;

1.6. produkte për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe instalimeve që përdoren për prodhimet bimore, përfshirë ruajtjen e deponimin në një fermë bujqësore.

1.7. produktet dhe substancat e përfshira në listat e kufizuara mund të përdoren vetëm nëse përdorimi i tyre autorizohet sipas legjislacionit në fuqi.

2. Autorizimi i produkteve dhe substancave sipas paragrafit 1. të këtij neni iu nënshtrohet objektivave dhe parimeve të përcaktuara në Kreun II të këtij ligji, kriterëve të përgjithshme dhe specifike në vazhdim:

2.1. përdorimi i tyre është i nevojshëm për prodhim të qëndrueshëm dhe esencial për atë lloj përdorimi;

2.2. të gjitha produktet dhe substancat duhet të jenë me origjinë bimore, shtazore, mikrobiale apo minerale përveç në rastet kur produktet apo substancat nga burime të tilla nuk gjenden në sasi të mjaftueshme apo me cilësinë e duhur ose kur nuk gjenden alternativa të tjera;

3. Në rastin e produkteve sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.1 të këtij neni zbatohen rregullat si në vijim:

3.1. përdorimi i tyre është themelor për luftimin e një organizmi të dëmshëm apo një sëmundje të caktuar për të cilat nuk ka zgjedhje të tjera biologjike, fizike apo të ofruar nga seleksionimi gjenetik, praktika kultivimi ose praktika të tjera bujqësore të efektshme;

3.2. nëse produktet nuk kanë origjinë bimore, shtazore, mikrobiale apo minerale dhe nuk janë identike me formën e tyre natyrale, ato mund të autorizohen vetëm nëse përdorimi i tyre mënjanon çfarëdo kontakti direkt me pjesën e ngrënëshme të bimëve;

3.3. në rastin e produkteve sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.2 të këtij neni, përdorimi i tyre është thelbësor në rritjen dhe ruajtjen e pjellorisë së tokës apo për të përmbushur kërkesat ushqyese specifike të bimëve, apo për qëllime specifike përmirësimi të kushteve të tokës;

4. Në rastin e produkteve sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.3 dhe 1.4 të këtij neni, zbatohen rregullat si në vijim:

4.1. të jenë të domosdoshme për mbrojtjen e shëndetit të kafshëve, për mbarështimin dhe vitalitetin e kafshëve dhe të sigurojnë të ushqyerit e duhur duke plotësuar nevojat fiziologjike dhe jetësore të llojeve në fjalë ose në rast se këto ushqime për kafshë nuk mund të prodhohen apo ruhen pa përdorimin e këtyre substancave;

4.2. ushqime për kafshë me origjinë minerale, oligoelementet, vitaminat apo provitaminat të kenë orgjinë natyrore. Nëse këto substanca nuk gjenden, mund të

autorizohen për përdorim në prodhimin organik substanca të përcaktuara mirë kimikisht dhe me efekt të njëjtët;

5. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet dhe kufijtë në të cilat produktet dhe substancat e referuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të përdoren, metodat e përdorimit, dozimin, afatet kohore të përdorimit dhe kontaktin me produktet bujqësore dhe, nëse është e nevojshme, mund të vendosë për heqjen nga përdorimi të këtyre produkteve dhe substancave.

6. Kur Komisioni për Bujqësinë Organike sipas nenit 37 të këtij ligji konsideron se një produkt apo substancë duhet të shtohet apo të hiqet nga lista sipas paragrafit 1 të këtij neni, apo për të cilin duhet të ndryshohen specifikat e përdorimit sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.1, të këtij neni i njëjti Komision siguron përgatitjen dhe dërgimin zyrtarisht të një dosje Autoritetit Kompetent ku jepen arsyet për përfshirjen, heqjen apo ndryshimet.

7. Kërkesat për ndryshim apo heqje, si dhe vendimet përkatëse duhet të publikohen.

8. Produktet dhe substancat e përdorura para vënies në veprim të këtij ligji për qëllimet që përputhen me ato të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, mund të vazhdojnë të përdoren pas këtij ndryshimi, Ministria mund t'i heqë nga përdorimi këto produkte apo substanca.

Neni 16 **Konvertimi**

1. Rregullat në vijim duhet të zbatohen në fermat bujqësore të cilat fillojnë prodhimin organik:

1.1. periudha e konvertimit fillon jo përpara datës kur operatori apo fermeri ka deklaruar aktivitetin e tij tek autoriteti kompetent dhe i'a ka nënshtruar fermën e tij sistemit të kontrollit në përputhje me nenin 31 të këtij ligji;

1.2. gjatë periudhës së konvertimit zbatohen të gjitha rregullat e përcaktuara me këtë ligj;

1.3. periudhat e konvertimit përcaktohen si të veçanta për prodhimin bimor apo të kafshëve;

1.4. në një fermë apo njësi pjesërisht në regjim të prodhimit organik dhe pjesërisht në konvertimin drejt prodhimit organik, operatori duhet t' i mbajë të ndara produktet e prodhuara në fermë organike nga ato në konvertim e sipër dhe kafshë të ndara ose që mund të ndahen me lehtësi dhe kjo ndarje të ketë dokumentat përkatëse;

1.5. për të përcaktuar periudhën e konvertimit sipas këtij neni, mund të merret parasysh një periudhë që i paraprin datës së fillimit të periudhës së konvertimit, mjafton që të përmbushen disa kushte të caktuara;

1.6. kafshët dhe produktet shtazore të prodhuara gjatë periudhës së konvertimit sipas nënparagrafit 1.4 të këtij paragrafi nuk tregtohen me treguesit e përcaktuar në nenet 22 dhe 23 të këtij ligji, tregues të cilët përdoren në etiketimin dhe reklamën e produkteve.

2. Masat dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e rregullave, periudhat e caktuara sipas këtij neni përcaktohen me akt nënligjorë nga Ministria.

Neni 17

Rregullat e përgjithshme për prodhimin e ushqimit të përpunuar për kafshë

1. Prodhimi i ushqimit organik të përpunuar për kafshë duhet të bëhet në mënyrë të veçantë dhe në kohë e hapësirë të ndryshme nga prodhimi i ushqimit të përpunuar jo organik për kafshë.

2. Në përbërjen e ushqimit organik për kafshë nuk duhet të përzihet lëndë e parë për ushqim për kafshë organike apo nga ferma në konvertim me lëndë të para të prodhuara me metoda jo organike.

3. Çdo lëndë e parë, ushqim për kafshë që përdoret apo përpunohet në prodhimin organik nuk lejohet të përpunohet me anën e tretësve të sintetizuar kimikisht.

4. Nuk lejohet të përdoren substanca dhe teknika për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit organik për kafshë, apo për të qenë korrekt gjatë përpunimit apo që mund të mbulojnë natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

5. Ministria me akt nënligjor e përcakton përmbajtjen e rregullave të zbatimit të prodhimit ushqimor organik.

Neni 18

Rregullat e përgjithshme për prodhimtarinë e ushqimit të përpunuar

1. Përgatitja e ushqimit të përpunuar organik duhet të bëhet në mënyrë dhe kohë të ndarë dhe në vende të ndryshme nga ato ku përgatitet ushqimi jo organik.

2. Për përbërjen e ushqimit organik të përpunuar zbatohen rregullat si në vijim:

2.1. produkti duhet të prodhohet kryesisht nga përbërës me origjinë bujqësore, për të përcaktuar nëse një produkt është prodhuar kryesisht nga përbërës me origjinë bujqësore, nuk merren parasysh uji dhe kripa e gjellës që shtohen në të;

2.2. në produktet ushqimore mund të përdoren vetëm lëndë shtesë, lëndë ndihmëse në përpunim, aroma, ujë, kripë, lëndë me bazë mikroorganizmash, enzimash, lëndë minerale dhe oligominerale, vitamina, aminoacide, mikrolëndë të tjera ushqyese për artikuj ushqimorë për përdorime të veçanta dhe vetëm nëse janë të autorizuar për përdorim në prodhimin organik në pajtim me këtë nen.

2.3. përbërësit me origjinë nga bujqësia jo organike mund të përdoren vetëm nëse janë të autorizuar për përdorim në prodhimin organik në pajtim me nenin 20 të këtij ligji;

2.4. një përbërës organik nuk duhet të jetë i pranishëm bashkë me të njëjtin përbërës në formë jo organike apo të ardhur nga bujqësia në konvertim;

2.5. ushqimet e prodhuara nga kulturat në konvertim duhet të përmbajnë vetëm një përbërës bimor me origjinë bujqësore.

3. Nuk lejohet të përdoren substanca dhe teknika për të rivendosur cilësitë e humbura gjatë përpunimit dhe ruajtjes së ushqimit organik, dhe për të qenë korrekt gjatë përpunimit apo që mund të mbulojnë natyrën e vërtetë të këtyre produkteve.

4. Masat dhe kushtet e nevojshme për zbatimin e rregullave të prodhimit dhe metodave të përpunimit sipas këtij neni përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

Neni 19

Rregullat e përgjithshme të prodhimit të tharmit organik

1. Për prodhimin e tharmit organik duhet të përdoren vetëm substrate të prodhuara në mënyrë organike. Produkte dhe substanca të tjera mund të përdoren vetëm nëse janë të autorizuar për t'u përdorur në prodhimin organik në përputhje me nenin 20 të këtij ligji.

2. Tharmi organik nuk është i pranishëm në ushqime apo ushqim organik për kafshë bashkë me tharm jo organik.

3. Rregullat për këtë prodhim përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 20

Kriteret për produktet dhe substanca të caktuara gjatë përpunimit

1. Autorizimi i produkteve dhe substancave për t'u përdorur në prodhimtarinë organike dhe përfshirja e tyre në listën e kufizimeve të produkteve dhe substancave sipas nenit 18, paragrafi 2 nënparagrafi 2.1 dhe 2.3 të këtij ligji, do të jetë subjekt i objektivave dhe parimeve të vendosura në kreun II të këtij ligji dhe kriterëve në vazhdim, të cilat duhet të vlerësohen në tërësi:

1.1. kur nuk disponohen mënyra të tjera të autorizuar në pajtim me këtë kapitull;

1.2. kur do të ishte e pamundur të prodhohen apo të ruhen ushqimet apo të plotësohen kërkesat dietetike të vendosura në bazë të legjisllacionit në fuqi pa përdorimin e tyre.

2. Produktet dhe substancat sipas nenit 18, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2 të këtij ligji gjenden në natyrë dhe mund t'u jenë nënshtruar vetëm proceseve mekanike, fizike, biologjike,

enzimatike apo mikrobiale, dhe autorizimi i përdorimit të tyre bëhet vetëm kur këto produkte dhe substanca nga burime të tilla nuk gjenden në treg në sasi të mjaftueshme apo me cilësinë e duhur.

3. Për autorizimin e produkteve dhe substancave dhe përfshirjen e tyre në listën e kufizuar që përcaktohen në paragrafin 1 të këtij neni, përcaktimin e kushteve dhe kufijtë specifikë për përdorimin e tyre, e nëse është e nevojshme edhe për heqjen e produkteve përcaktohet me akt nënligjor nga Ministria.

4. Kur Komisioni për Bujqësi Organike vlerëson se nga lista sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të shtohet apo të hiqet një produkt apo substancë, apo të ndryshohen specifikimet e përdorimit sipas këtij paragrafi, ky Komisioni siguron përcjelljen zyrtare Autoritetit Kompetent të një dosje ku jepen arsyet për përfshirjen, heqjen apo ndryshimet.

5. Kërkesat për ndryshimet apo heqjet, si dhe vendimet mbi to duhet të publikohen në web faqen e Ministrisë.

6. Produktet dhe substancat e përdorura përpara hyrjes në fuqi, sipas nenit 18 paragrafit 2 nënparagrafit 2.2 dhe 2.3 të këtij ligji, mund të përdoren nëse janë në pajtim, apo mund të hiqen nga lista pas hyrjes në fuqi të këtij ligji nga Ministria.

Neni 21

Përfshirja nga rregullat e prodhimit

1. Autoriteti kompetent, në përputhje me objektivat e përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 dhe 12 të këtij ligji, që parasheh sigurimin e përfshirjeve nga rregullat specifike të prodhimit organik .

2. Përfshirjet sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të jenë minimale dhe, kur është e nevojshme, në një kufi kohor dhe të zbatueshme vetëm në rastet si në vijim:

2.1. kur ato janë të nevojshme për të siguruar fillimin apo vazhdimësinë e prodhimit organik në ferma të kushtëzuara nga faktorë klimatikë, gjeografikë apo strukturorë;

2.2. kur ato janë të nevojshme për të siguruar furnizim me ushqim për kafshët, farëra dhe material riprodhues vegjetativ, kafshë të gjalla dhe faktorë të tjerë të prodhimit bujqësor të cilët nuk gjenden në treg në formë organike;

2.3. kur janë të nevojshme për të siguruar furnizim me lëndë përbërëse me origjinë bujqësore, ku këta përbërës nuk gjenden në treg në formë organike;

2.4. kur janë të nevojshme për zgjidhjen e problemeve specifike që lidhen me mbarëshkrimin e kafshëve blegtorale për prodhimtari organike;

2.5. kur janë të nevojshme për përdorimin e produkteve dhe substancave specifike gjatë përpunimit sipas nenit 18 paragrafit 2, nënparagrafit 2.2 të këtij ligji në mënyrë që të sigurohet prodhimi i produkteve bujqësore të qëndrueshme në formë organike;

2.6. kur nevojitet marrja e masave të përkohshme për të lejuar vazhdimin apo rifillimin e prodhimit organik në rastet e rrethanave emergjente;

2.7. kur është i nevojshëm përdorimi i lëndëve shtesë të ushqimit dhe i substancave të tjera sipas nenit 18 paragrafit 2, nënparagrafit 2.2 të këtij ligji apo lëndë shtesë për ushqim për kafshë dhe substancat të tjera si përcaktohen në nenin 15 paragrafin 1 nënparagrafin 1.4 të këtij ligji dhe kur këto lëndë e substanca nuk gjenden në treg përveçse të prodhuara nga OMGJ-të;

2.8. kur përdorimi i lëndëve shtesë të ushqimit dhe i substancave të tjera sipas nenit 18 paragrafit 2, nënparagrafit 2.2 të këtij ligji apo i lëndëve shtesë për ushqim për kafshë sipas nenit 15 paragrafit 1 nënparagrafit 1.4 të këtij ligji, kërkohet në bazë të ligjit të vendit.

3. Ministria me akt nënligjor përcakton kushtet specifike për zbatimin e përfundimeve të parapara nga paragrafi 1. i këtij neni.

KREU IV VENDOSJA E ETIKETËS

Neni 22

Emërtimet që përdoren në prodhimin organik

1. Një produkt konsiderohet se vjen nga përdorimi i metodave të prodhimit organik, kur në etiket, në reklama apo në dokumente tregtare, ky produkt, përbërësit e tij apo të ushqimit për kafshë, përshkruhen me fjalë që i njoftojnë blerësit se produkti, përbërësit e tij apo të ushqimit për kafshë janë përftuar në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj. Veçanërisht, fjala “organik” dhe fjalët rrjedhëse apo shkurtesa si ‘bio’ dhe ‘eko’, të vetme apo bashkë me të tjera, mund të përdoren në tërë Kosovën për etiketim dhe reklamë të produkteve të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë ligj.

2. Në etiketimin dhe reklamën e produkteve të gjalla apo të papërpunuara bujqësore, fjalët që i referohen metodës së prodhimit organik mund të përdoren vetëm atëherë kur, përveç të tjerave, edhe gjithë përbërësit e atij produkti janë prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Emërtimet sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk do të përdoren në etiketa, reklama dhe në dokumenta tregtare të një produkti i cili nuk plotëson kushtet e përcaktuara nga ky ligj,

përveçse kur ato nuk përdoren as për produktet bujqësore ushqimore apo ushqim për kafshë që nuk lidhen me prodhimin organik.

4. Në etiketa dhe në reklama nuk pranohet asnjë emërtim, përfshirë emërtimet që përdoren në markat apo praktikat tregtare e që mund të çorientojnë konsumatorin apo përdoruesin duke i sugjeruar se një produkt apo përbërësit e tij plotësojnë kushtet që përcakton ky ligj.

5. Emërtimet sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk do të përdoren për një produkt për të cilin duhet të tregohet në etiketë apo reklamë se përmban OMGJ, përbëhet nga OMGJ apo është përfituar nga OMGJ sipas dispozitave ligjore.

6. Sa iu përket ushqimeve të përpunuara, emërtimet sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përdoren në përshkrimin e shitjeve me kusht që:

6.1. ushqimet e përpunuara të jenë në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;

6.2. të paktën nëntëdhjetë e pesë përqind (95%) e peshës së përbërësve të tyre me origjinë bujqësore të jenë organikë;

6.3. vetëm në listën e përbërësve, me kusht që ushqimet të jenë në përputhje me nenin 18 paragrafi 2 nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.4 të këtij ligji.

7. në listën e përbërësve dhe në të njëjtën hapësirë të përshkrimit të shitjeve, me kusht që:

7.1. përbërësi kryesor të jetë produkt i gjuetisë apo peshkimit;

7.2. të përmbajë përbërës të tjerë me origjinë bujqësore të cilët janë të gjithë organikë;

7.3. ushqimi të jetë në përputhje me nenin 18 paragrafi,1 dhe 2, nënparagrafi 2.1, 2.2 dhe 2.4, të këtij ligji.

8. Lista e përbërësve tregon cilët përbërës janë organikë.

9. Në rastet kur zbatohen nënparagrafët 6.2 dhe 6.3 të paragrafit 6 të këtij neni, referimet ndaj metodës së prodhimit organik mund të bëhen vetëm lidhur me përbërësit organikë dhe lista e përbërësve përfshin një tregues të përqindjes së përgjithshme të përbërësve organikë në përpjesëtim me sasinë e përgjithshme të përbërësve me origjinë bujqësore.

10. Emërtimet dhe treguesit e përqindjes sipas paragrafit 4 të këtij neni paraqiten me të njëjtat ngjyra, madhësi dhe lloje të germave sikurse edhe treguesit e tjerë në listën e përbërësve.

Neni 23 **Tregues të detyrueshëm**

1. Kur përdoren emërtimet sipas nenit 22 paragrafit 1 të këtij ligji:

1.1. në etiketë vendoset edhe numri i kodit sipas nenit 27 paragrafi 7 i këtij ligji, të autoritetit të kontrollit apo organit të kontrollit, nga ku varet operatori i cili ka kryer prodhimin apo përgatitjen e fundit;

1.2. sa i përket ushqimeve të parapaketuara, mbi paketim vendoset edhe logoja kombëtare sipas nenit 24 të këtij ligji.

2. Treguesit sipas paragrafit 1 të këtij neni vendosen në mënyrë që të jenë lehtësisht të dukëshëm, të lexueshëm qartë dhe të mos mund të fshihen.

3. Ministria me akt nënligjor vendos kriteret specifike lidhur me paraqitjen, përbërjen dhe përmasat e treguesve të përcaktuar në paragrafin 1, nënparagrafët 1.1 dhe 1.2, të këtij neni.

Neni 24 **Logot e prodhimit organik**

1. Ministria me akt nënligjor përcakton një logo për Kosovën, kriteret specifike lidhur me paraqitjen e saj, përbërjen, madhësinë dhe dizajnin e saj.

2. Logoja e prodhimit organik e Kosovës mund të përdoret në etiketa, paraqitje dhe reklama të produkteve të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë ligj.

3. Logoja nuk duhet të përdoret nëse produktet dhe ushqimet nuk janë konvertuar sipas nenit 16 paragrafit 1. nënparagrafit 1.4. të këtij ligji.

4. Logot kombëtare dhe private mund të përdoren në etiketim, në paraqitje dhe reklamim të produkteve të cilat plotësojnë kërkesat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 25 **Kërkesat specifike për etiketimin**

1. Ministria me akt nënligjor përcakton rregullat specifike të etiketimit dhe përmbajtjes së saj, të cilat zbatohen për:

1.1. ushqimin organik të kafshëve;

1.2. produktet në konvertim me origjinë bimore;

1.3. materialin riprodhues vegjetativ dhe farërat për kultivim.

KREU V KONTROLLET

Neni 26 Sistemi i Kontrollit

Ministria është përgjegjëse për sistemin e kontrollit e cila krijon një autoritet kontrolli. Autoriteti i kontrollit përcakton trupat e kontrollit të cilët janë përgjegjëse për kontrollet e operatorëve lidhur me detyrimet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të nxjerra sipas tij.

Neni 27 Autoriteti i Kontrollit dhe Trupat e Kontrollit

1. Trupat e kontrollit të cilat synojnë të kryejnë detyrat e kontrollit zyrtar i paraqesin kërkesë të veçantë Ministrisë sipas një modeli i cili duhet të publikohet me akt nënligjor. Ministria në afat prej nëntëdhjetë (90) ditësh nga data e pranimit të kërkesës duhet të lëshojë autorizimin apo ta refuzojë me arësytimin e duhur dhe të njoftojë palët.

2. Nëse të dhënat e paraqitura nga trupat e kontrollit nuk janë të plota, Ministria mund të kërkojë plotësim të mëtejshëm të dhënave.

3. Për lëshimin e autorizimit sipas paragrafit 1. të këtij neni, Ministria duhet të verifikojë nëse janë plotësuar kushtet në vijim:

3.1. ka një përshkrim të saktë të detyrave që mund të kryejë Trupi i Kontrollit dhe kushtet në të cilat mund t'i zbatojë ato;

3.2. ka prova që Trupi i Kontrollit ka përvojë, pajisje dhe infrastruktur të nevojshme për të kryer detyrat që i ngarkohen;

3.3. ka një staf me numër të mjaftueshëm të kualifikuar dhe me përvojë;

3.4. është i paanshëm dhe nuk ka asnjë konflikt interesi lidhur me ushtrimin e detyrave që i janë ngarkuar;

3.5. Trupi i Kontrollit duhet të jetë i akredituar sipas versionit aktual të publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian, seria C, të Standardit Europian EN 45011 apo ISO Udhëzuesi 65 'Kërkesa të përgjithshme për organet që drejtojnë sistemet certifikues të produkteve;

3.6. Trupi i Kontrollit e njofton rregullisht Ministrisë rezultatet e kontrolleve të kryera dhe sa herë që e kërkon Ministria. Nëse rezultatet e kontrolleve tregojnë për

mosrespektim apo dyshojnë parregullsi, Trupi i Kontrollit duhet menjëherë të njoftojë ministrinë;

3.7. egziston një koordinim i efektshëm ndërmjet Ministrisë e cila jep autorizimin dhe Trupit të Kontrollit.

4. Gjatë miratimit të një Trupi të Kontrollit, përveç dispozitave të paragrafit 2. të këtij neni, Ministria merr parasysh kriteret në vijim:

4.1. procedurën standarde të kontrollit që duhet ndjekur, përfshirë një përshkrim të detajuar të masave të kontrollit dhe masave preventive që ndonjë trup merr përsipër t'i ushtrojë ndaj operator-ëve të cilët vendosen nën kontrollin e tij;

4.2. masat që mendon të marrë Trupi i Kontrollit atje ku gjenden parregullsi apo shkelje.

5. Ministria mund të mos ia delegojë Trupit të Kontrollit detyrat e kontrollit si vijon:

5.1. mbikëqyrjen dhe auditimin e trupave të tjera të kontrollit;

5.2. kompetencat për të bërë përjashtime ndaj rregullave të prodhimit organik të përcaktuara me këtë ligj.

6. Nëse Ministria ju delegon trupave të kontrollit detyrat e kontrollit, ajo duhet të kryejë auditime apo inspektime të rregullta atyre trupave të posaçme të kontrollit për të vërtetuar se ato operojnë në pajtim me detyrat që ju janë ngarkuar.

7. Nëse, pas rezultatit apo inspektimit konstatohet se këto trupa nuk po i kryejnë siç duhet detyrat që ju janë ngarkuar, Ministria mund t'ua marr këtë autorizim. Autorizimi u merret pa vonesë në qoftë se trupi i kontrollit nuk arrin të ndërmarrë si duhet dhe në kohë veprimet për korrigjimin e parregullsive.

8. Përveç dispozitave të paragrafit 5 të këtij neni, Ministria duhet të:

8.1. sigurojë që kontrollet e kryera nga trupi i kontrollit të jenë objektive dhe të pavarura;

8.2. vërtetojë efektshmërinë e këtyre kontrolleve;

8.3. merr shënim për çdo parregullsi apo shkelje të vërtetuar dhe për masat korrigjuese që jenë marrë;

8.4. ia merr miratimin atij trupi kur ai nuk plotëson kushtet e përcaktuara në nënparagrafët 8.1 dhe 8.2 të këtij paragrafi dhe kushtet e nevojshme për të qenë i miratuar.

9. Ministria duhet të pajisë me një kod të veçantë çdo autoritet të kontrollit dhe trup të kontrollit i cili kryen detyrat e kontrollit sipas nenit 26 të këtij ligji.

10. Kodi sipas paragrafit 9 të këtij neni përbëhet nga një pjesë e përcaktuar (KS ORG) dhe një numër progresiv, i cili përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

11. Autoriteti i Kontrollit dhe Trupat e kontrollit duhet t'i lejojë Ministrisë qasje në zyrat dhe objektet e tyre dhe të sigurojnë çdo informim dhe ndihmë që konsiderohet e nevojshme nga Ministria për përmbushjen e detyrimeve të tyre në përputhje me këtë ligj.

12. Autoriteti i kontrollit dhe trupat e kontrollit duhet të sigurojnë që natyra, fusha e veprimit dhe frekuenca e kontroleve dhe detyrat e kontrollit të plotësojnë një minimum të kërkesave të përcaktuara me këtë ligj apo akte nënligjore të nxjerra në bazë të tij.

13. Ministria duhet të sigurojë që sistemi i ngritur i kontrollit të lejojë hulumtimin e origjinës së secilit produkt në të gjitha fazat e prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes në mënyrë që t'u japë konsumatorëve garanci se produktet organike janë prodhuar në përputhje me kërkesat e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 28

Raportet Vjetore të Autoriteteve të Kontrollit dhe Trupave të Kontrollit

1. Çdo vit, jo më vonë se 31 Janar, Autoriteti i Kontrollit dhe Trupat e Kontrollit i dërgojnë Ministrisë listën e operatorëve të cilët janë kontrolluar prej tyre deri më 31 Dhjetor të vitit të mëparëshëm.

2. Çdo vit, deri më 31 mars, Ministrisë i dërgohet një raport përmbledhës i veprimtarive të kontrollit të kryera gjatë vitit të mëparëshëm.

Neni 29

Rregullat e Zbatimit të kontrollit

1. Ministria përcakton rregulla të detajuara me akte nënligjore lidhur me:

1.1. dhënien e kompetencave të kontrollit autoritetit të kontrollit;

1.2. delegimin e detyrave të kontrollit trupave të kontrollit;

1.3. kryerjen e detyrave të kontrollit nga autoriteti i kontrollit dhe trupat e kontrollit;

1.4. natyrën, fushëveprimin dhe frekuencën e kontroleve zyrtare;

1.5. veprimet që duhet të ndërmerren në rast të mosrespektimit apo parregullsive.

Neni 30

Qasja në sistemin e kontrollit

1. Çdo operator që prodhon, përgatit, ruan apo importon nga një vend i tretë produkte sipas nenit 2 të këtij ligji, apo që vendos në treg produkte të tilla, duhet që para se të vendosë në treg çfarëdo prodhimi si organik apo në konvertim drejt organikut:

1.1. e njofton Ministrinë për aktivitetin e tij dhe në të vyejtën kohë i ofron një kopje të informatave të njëjta Autoritetit të Kontrollit dhe Trupave të Kontrollit;

1.2. i paraqet veprimtarinë e tij sistemit të kontrollit sipas nenit 27 të këtij ligji.

2. Paragrafi 1 i këtij neni duhet të zbatohet edhe për eksportuesit të cilët eksportojnë produkte të prodhuara në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj apo me akte nënligjore të nxjerra sipas këtij ligji.

3. Edhe kur një operator nënkontraktin ndonjë aktivitet me palë të tjera ky operator duhet t'u nënshtrohet kërkesave sipas paragrafit 1, nënparagrafët 1.1. dhe 1.2, të këtij neni dhe këto aktivitete të nënkontraktuara i nënshtrohen sistemit të kontrollit.

4. Operatorët të cilët i'a shesin produktet e parapaketuara drejtpërdrejt konsumatorit të fundit apo përdoruesit, me kusht që ata të mos prodhojnë, përgatisin, ruajnë produkte përveçse për një pikë shitje, apo importojnë produkte të tilla nga një vend i tretë apo që nuk i kanë kontraktuar aktivitete të tilla një pale të tretë, përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

5. Ministria siguron që çdo operator i cili plotëson rregullat e përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerra prej tij, dhe i cili paguan taksën si kontribut për shpenzimet e kontrollit, ka të drejtë të mbulohet nga sistemi i kontrollit.

6. Ministria cakton me akt nënligjor sistemin dhe masën e taksave që duhet të paguhen si kontribut për shpenzimet e kontrollit.

7. Autoriteti i kontrollit dhe trupat e kontrollit mbajnë një listë të freskuar me emrat dhe adresat e operatoreve nën kontrollin e tyre, e cila publikohet në mënyrë që të jetë lehtësisht në dispozicion për gjithë palët e interesuara.

8. Ministria miraton rregullat e zbatimit për të dhënë detajet e procedurave të njoftimit dhe përfshirjes në sistemin e kontrollit sipas paragrafit 1 të këtij neni, në veçanti të dhënave që përfshihen në njoftimin sipas paragrafit 1 nënparagrafit 1.1. të këtij neni.

Neni 31

Dokumentimi i të dhënave

1. Autoriteti i kontrollit dhe trupat e kontrollit lëshojnë dëshmi të dokumentave për çdo operator i cili kontrollohet prej tyre dhe i cili me aktivitetet e tij, i plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nën ligjore për zbatim të këtij ligji.
2. Të dhënat e dokumentuara duhet të mundësojnë të paktën identifikimin e operatorit, llojin e aktivitetit, llojshmërinë apo gamën e produkteve si dhe afatin e vlefshmërisë së tyre.
3. Operatorët duhet të verifikojnë të dhënat e dokumentara të furnizuesve të tyre.
4. Forma e të dhënave të dokumentave është përcaktuar në Aneksin 1, i cili është pjesë përbërëse e këtij ligji.

Neni 32

Masat në rast të shkeljeve dhe parregullsive

1. Kur gjendet një parregullsi në mosrespektimin e kërkesave të këtij ligji, autoriteti i kontrollit ose trupi i kontrollit duhet të sigurojnë që në etiketën dhe reklamën e gjithë mallit apo të gjithë ciklit të prodhimit të ndikuar nga kjo parregullsi të mos përmendet fare metoda e prodhimit organik, nëse kjo parregullsi është në përpjestim me rëndësinë e kërkesës e cila është shkelur, me natyrën dhe rrethanat e veçanta të veprimtarive të parregullta.
2. Kur gjendet shkelje e rëndë apo shkelje me ndikim të vazhduar, autoriteti i kontrollit ose trupi i kontrollit e ndalon atë operator të nxjerrë në treg produkte me etiketë dhe reklamë ku përmendet metoda e prodhimit organik për një periudhë që vendoset në marrëveshje me Ministrinë.
3. Njoftimet për rastet e parregullsive apo shkeljeve të cilat prekin statusin organik të një produkti, përcillen menjëherë ndërmjet Trupave të Kontrollit, Autoriteteve të Kontrollit dhe Ministrisë.
4. Shkalla e komunikimit do të varet nga madhësia dhe shtrirja e parregullsive apo e shkeljeve të gjetura.
5. Forma dhe modalitetet e këtyre komunikimeve përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

KREU VI IMPORTI

Neni 33 Rregullat e Importit

1. Ministria mund të autorizojë importuesit të cilët kanë deklaruar aktivitetin e tyre sipas nenit 30 të këtij ligji për të vendosur në tregun vendor si produkte organike nga një vend i tretë, me kusht që importuesi të japë prova të mjaftueshme se janë plotësuar kushtet në vijim:

1.1. produkti është prodhuar në pajtim me rregullat e prodhimit dhe etiketimit ekuivalente me ato të parapara me këtë ligj;

1.2. operatorët u janë nënshtruar masave të kontrollit me efektshmëri ekuivalente me ato të parapara me këtë ligj, dhe këto masa kontrolli janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të efektshme;

1.3. produkti shoqërohet me certifikatë inspektimi e lëshuar nga Ministria, Autoriteti i Kontrollit apo Trupat e Kontrollit të vendit të tretë ku vërtetohet se produkti plotëson kushtet e përcaktuara nga ky paragraf.

2. Originali i certifikatës sipas këtij paragrafi, i shoqëron mallrat në objektet e marrësit të parë të ngarkesës, më pastaj importuesi duhet të ketë certifikatën në dispozicion të Autoritetit të Kontrollit apo Trupit të Kontrollit por jo më pak se dy (2) vite.

3. Ministria me akte nënligjore, njofton vendet e treta sistemi prodhues i të cilave përputhet me parimet, rregullat e prodhimit dhe masat e kontrollit ekuivalente me ato të përcaktuara në këtë ligj dhe harton një listë të këtyre vendeve. Në vlerësimin e ekuivalencës merret parasysh udhëzuesi Codex Alimentarius CAC/GL 32.

4. Sipas paragrafit 2. të këtij neni, Shtetet anëtare të BE-së dhe vendet e treta të përfshira apo që do të përfshihen në Listën Ekuivalente të Rregullores së KE-së 1235/08, Aneksi III, dhe freskimi i saj i ardhshëm, janë dhe do të konsiderohen de facto në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë ligj. Produktet që vijnë nga këto vende duhet të shoqërohen me një certifikatë të inspektiveve, siç parashikohet në paragrafin 1 nënparagrafi 1.3 të këtij neni.

5. kriteret, standardet dhe kushtet për importimin e produkteve organike në Kosovë përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministria.

KRU VII DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 34

Dispozitat Ndëshkimore – Sanksionet

1. Me dënim me gjobë prej pesqind (500) € deri pesmijë (5.000) € dënohet për kundërvajtje personi fizik apo juridik, nëse vepron në kundërshtim me nenet 7, 8, dhe 31 të këtij ligji dhe përdor produkte dhe substanca të pa autorizuar në bujqësinë organike sipas nenit 16 të këtij ligji, do të jetë fajtor për shkelje të ligjit.
2. Me dënim me gjobë prej njëmijë (1.000) € deri tremijë (3.000) € dënohet personi përgjigjës i personit juridik, nëse bën shkelje të këtij ligji apo ndonjë akti nënligjor të nxjerr nga ky ligj.

KREU VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

Të dhënat dhe njoftimet statistikore

1. Ministria mban shënime dhe të dhëna statistikore lidhur me Autoritetin e Kontrollit, Trupat e Kontrollit dhe Operatorët, dhe publikon çdo vit listën e tyre në Web faqen e Ministrisë.
2. Autoriteti Kompetent përpunon njoftimin statistikor mbi sektorin organik në Kosovë në mënyrë që të marrë pjesë në sistemin e Bashkimit Europian të të dhënave statistikore të bujqësisë organike Eurostat.

Neni 36

Programi Kombëtar për Bujqësi Organike

1. Ministria duhet të hartojë dhe publikojë Programin Shtetëror për Bujqësinë Organike për të stimuluar prodhimin organik në Kosovë.
2. Programi vendosë masat për mbështetje drejtpërdrejt dhe jo drejtdrejt të prodhuesve të produkteve organike dhe zhvillimin e prodhimit organik, si dhe mjetet për zbatimin e tyre.
3. Mjetet financiare për këtë program mund të sigurohen nga:
 - 3.1. buxheti i Republikës së Kosovës;
 - 3.2. dhurime, kredi; dhe

3.3. burime të tjera të ardhurash.

Neni 37
Komisioni për Bujqësi Organike

1.Ministria formon “Komisionin për Bujqësi Organike” për të mbështetur zhvillimin, promovimin dhe koordinimin e prodhimit organik në Kosovë.

2. Përbërja, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit nga paragrafi 1. i këtij neni përcaktohen me akt nënligjor nga Ministria.

Neni 38

Të gjitha mjetet e grumbulluara në pajtim me këtë ligj do të derdhën në buxhetin e Kosovës.

Neni 39
Shfuqizimi

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 02/L-122 i datës 17 shtator 2007.

2. Ministria, brenda afatit kohor prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e tij.

Neni 40
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-085
13 shtator 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-085

PËR PËR BUJQËSI ORGANIKE

Aneksi 1

Modeli i të dhënave dokumentare të operatorit sipas Nenit.....të ligjit

Modeli i të dhënave dokumentare të operatorit	
1. Numri i dokumentit	
2. Emri dhe adresa e operatorit: Aktiviteti kryesor (prodhues, përpunues, importues, etj.)	3. Emri, adresa dhe numri i kodit i Autoritetit të Kontrollit / Trupit të Kontrollit:
4. Grupet e prodhimit / Aktiviteti - bimë dhe prodhime bimore: - bagëti dhe prodhime blegtorale: - Gjallesa ujore dhe prodhime nga akuakultura:	5. Të përcaktuara si: Prodhim organik, produkte në konvertim; si dhe prodhim jo organik ku vazhdon në mënyrë paralele prodhim / përpunim sipas nenit.....të Ligjit

<p>- Prodhime të përpunuara:</p>	
<p>6. Afati i vlefshmërisë:</p> <p>Produkte bimore prej..... deri</p> <p>Blegtori dhe prodhime blegtorale prej..... deri</p> <p>Gjallesa ujore në akuakulturë dhe prodhime të gjallesave nga akuakultura prejderi</p> <p>Prukte të përpunuara prej..... deri</p>	<p>7. Data(t) e kontrollit (-eve)</p>
<p>8. Ky dokument hartohet në bazë të nenit të Ligjit Operatori i deklaruar i ka vendosur aktivitetet e veta nën kontroll dhe plotëson kërkesat e vendosura në ligjin në fjalë.</p> <p>Data, vendi:</p> <p>Nënshkrim në emër të Autoritetit të Kontrollit / Trupit të Kontrollit që e vendos në qarkullim</p>	